

DOKUMENTET PËR CERTIFIKATËN E USHTRIMIT TË PROFESIONIT PRIVAT ZJARRFIKËS

I. Dokumentacioni që duhet kur aplikohet si person fizik:

1. Kërkesë për lejen e ushtrimit të profesionit zjarrfikës privat, e cila i dërgohet Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së MZSH-së.
2. Curriculum Vitae
3. Akti i regjistrimit të subjektit sipas ligjislacionit në fuqi (ekstrakt nga QKB) i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi
4. Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen e të gjitha detyrimeve tatimore
5. Fotokopje e diplomës e noterizuar
6. 1 fotografi për dokumenta
7. Fotokopje e dokumentit të identifikimit (pasaportë ose kartë identiteti)
8. Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën dhe elektronike të subjektit që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.

II. Dokumentet që duhen kur personi aplikon në emër të një subjekti juridik:

1. Kur personi aplikon në emër të një subjekti juridik duhet të paraqesë kontratë individuale të lidhur me subjektin juridik, të emërtuar drejtues teknik për sigurinë në punë. Drejtuesi teknik duhet të ketë vjetërsi pune jo më pak se 3- 5 vjet.
2. Kontrata e lidhur me subjektin juridik për të emërtuarin drejtues teknik për sigurinë nga zjarri, të jetë e hartuar para noterit.
3. Vërtetim nga organet tatimore për shlyerjen nga shoqëria, të të gjitha detyrimeve tatimore për drejtuesin teknik.
3. Autorizimi që vërteton se personi, i cili paraqet kërkesën në emër të subjektit, - kur ky nuk është titullar i subjektit, - është i autorizuar prej këtij subjekti për të kërkuar lejen.

Kontrata midis përfaqësuesit ligjor dhe drejtuesve teknikë të rinj, të hartuar përpara noterit, me afat të përcaktuar (mbi 1 vit);

Dokumentacion teknik justifikues, për çka është përshkruar si veprimtari e kryer në CV; vërtetime nga subjekte, institucione apo organizma; projekte (ose pjesë të tyre) ku personi ka qenë bashkautor; certifikata kursi apo specializimi, që kanë lidhje me fushën dhe elektronike, të subjektit, që ka lëshuar vërtetimin apo të studios/projektuesit që ka hartuar projektin, në të kundërt dokumenti nuk do të konsiderohet si dokument justifikues për eksperiencën.

b) Ekstraktin historik apo ekstraktin për të dhënat e subjektit të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (i lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi), me të cilin dëshmohet, ndër të tjera, veprimtaria dhe statusi aktiv i shoqërisë/ose vendimin e gjykatës, për regjistrim si subjekt juridik.

Nuk lejohet të pajisen me licencë, në rolin e drejtuesit teknik për shoqëri, personat që punojnë në institucionet shtetërore qendrore, vendore, apo të pavarura dhe persona të tjerë, aktiviteti i të cilëve, bie ndesh me dispozitat ligjore apo nënligjore për nëpunësin civil.

Përsa u përket trajnimeve dhe hartimit të akteve të ekspertizës, duhet të kesh punuar të paktën 3 vjet në strukturat e shërbimit zjarrfikës.